Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

-
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe

informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiraturar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Data Center Primar dhe Data Center Sekondar me qëllim :

- Mirembajtje e shërbimeve IT, sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve ne 24/7 ne Site Primar.
- Mirembajtje e infrastruktures Dell në Disaster Recovery ekzistues në mënyrë që të jepet mundësia të mbajnë një kopje të shërbimeve kritike në rast të ndonjë problemi madhor ne Primary Site.
- Krijimi dhe konfigurimi për replikimin e të gjitha makinave virtuale nga site primar në site backup.

1.1. Situata Aktuale në Sektor

Aktualisht shërbimet bazë të IT-së që Posta Shqiptare i ofron punonjësve të saj, janë si më poshtë:

- E-mail, bazuar në Microsoft Exchange Server 2016 me mundësi aksesimi si nga rrjeti i brendshëm ashtu edhe nga rrjeti i jashtëm në adresën mail.postashqiptare.al.
- Autentifikim dhe kontroll të përdoruesve të postës shqiptare bazuar në Microsoft Active Directory dhe Domain Controller I ngritur mbi Microsoft Windows 2019.
- Shërbim file-sharing të hostuar në serverat e Postës Shqiptare
- Aksesimi në kohë reale i Sistemit Core Eterna në të gjitha zyrat e Postës Shqiptare
- Infrastruktura per ambientet test te sistemeve te Postes Shqiptare
- Infrastruktura Antivirus/Siem për përdoruesit fundor, pjese e rrjetit të kompjuterave të Postë Shqiptare.
- Infrastruktura për sistemet nderkombetare postare IPS/CD

Një pjesë e këtyre shërbimeve është ngritur mbi teknologji virtualizimi vmware mbi një platformë failovercluster në një infrastrukturë Fujitsu me tetë servera dhe një Storage PowerStore 500T, të lidhur me dy fibrechannel Brocade G620.

2. QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është mirembajtja e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbime ndaj përdoruesve. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Mirembajtja e paisjeve ne Primary Site per performace maksimale.
- Mirembajtja e paisjeve ne Disaster Recovery Site per performace maksimale.

2.2. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është përmirësimi i infrastrukturës hardware, software si dhe i optimizimit të infrastrukturës me disponueshmeri të lartë për të gjithë shërbimet, duke realizuar shërbimet si më poshtë:

- Mirembajtja dhe konfigurimi e infrastrukturës hardware aktuale bazuar saktësisht në kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike;
- Respektimi i parimit të konfidencialitetit të të dhënave;
- Testimi i përgjithshëm i sistemeve;

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Projekti do të përfundojë me sukses brenda afateve të përcaktuar në dokumentacionin për këtë procedurë;
- Autoriteti kontraktor do të vërë në dispozicion të operatorit ekonomik të gjitha informacionet lidhur me konfigurimet e infrastrukturës ekzistuese, dokumentet, rregulloret dhe materialet e nevojshme për implementimin e projektit;
- Informacioni i shkëmbyer mes palëve duhet të mbetet konfidencial;
- Staf i operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me disiplinë të ndryshme pune;

- Stafet përkatës të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe të aftë të bashkëpunojnë dhe të gjejnë konsensus;

3.2. Risqet

- Nivel i ulët bashkëpunimi mes pjesëtarëve të grupit të punës pranë Autoritetit Kontraktor;
- Nivel i ulët bashkëpunimi mes stafit të Autoritetit Kontraktor dhe atij të Operatorit Ekonomik;
- Mosrespektim i afateve;

4. QËLLIMI I PUNËS

SPECIFIKIMET TEKNIKE MIREMBAJTJE

Infrastruktura aktuale Disaster Recovery Site është e përbërë nga hardware dhe software sipas të dhënave të mëposhtme:

- **Infrastruktura Disaster Recovery Posta Shqiptare**

Nr	Produktet/Mirembajtje dhe shërbimet	Njesia	Sasia
1	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet PDU - APC AP7553 (0 U, 32 amper ... te furnizuara...nga paneli i shperndarjes ... te dy PDU-te lidhen tek dalja e perbashket e UPS-ve ne paralel);	Cope	2
2	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet Dell Switch N4032 ?	Cope	2
3	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet PowerEdge VRTX (SN SHASI_1: JDZNYR2, SN SHASI_2: JDZX4R2) (SN PowerEdge M630 Blade SERVERS: JDZSYR2, JDZT4R2, JDZTNR2, JDZTYR2, JDZVNR2, JDZV4R2, JDZWNR2, JDZW4R2)	Cope	1
4	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: Sistemi i kondicionimit HVAC - Liebert HPM S07A (dhe aksesoret perkates)	Cope	1
5	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: Sistem i mbrojtjes nga zjarri - Sistem Sevo Force 500 (dhe aksesoret perkates)	Cope	1

6	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: UPS 15kva - Schneider Electric (APC) ... Galaxy 300: G3HT15K3IB1S	Cope	2
7	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: Paneli i lidhjes se ups-ve. <ul style="list-style-type: none"> ● Panel Elektrik per vendosjen e automateve hyrje dalje te UPS-se; ● Automat sipas skemes se projektit (hyrje dhe dalje) ... 4 cope (2 + 2); ● Lidhjet automateve dhe vendosje e tyre ne panel; ● Kabllime 5 x 16mm (furnizim i UPS dhe dalje nga UPS); ● Kabllime 3 x 25 mm nga paneli kryesor tek paneli i shperndarjes. 	Cope	1
8	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: Paneli shperndares set. Automat 125A ... 2 cope (1 Linja/KESH dhe 1 nga UPS-te...dalja e perbashket e tyre) Automat 32A...6 cope ... (ku 4 cope prej tyre do te jene rezevere, per shtesa te mundshme ne te ardhmen... 2 nga KESH dhe 2 nga UPS); Kabllime 3x6/10mm (per kabinetin, nga linja/KESH dhe UPS)... 2 priza industriale (32 amper).	Cope	1
9	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet: Sistemi i sigurise dhe i monitorimit/kontrollit te parametrave ambientale - Netbotz: NBRK0250 (dhe sensoret perkates) . Sensoret qe jane te perfshire: <ul style="list-style-type: none"> ● Sensor dera, i montuar tek dera e rack-ut dhe qe lidhet me pajisjen e monitorimit/kontrollit me porten perkatese ... 1 cope; ● Sensor temperature dhe lageshtie (me kabell dhe porten perkatese) ... 1 cope; ● Sensor tymi me konektor RJ45 dhe me gjatesi >=3 metra... 1 cope; ● Sensor rrjedhjes/prezences se ujit ... 1 cope; ● Sensor temperature wireless (i vendosur tek rack-u)... 1 cope; ● Sensor vibrimi me konektor RJ45 dhe me gjatesi >=3.5 metra ... 1 cope; 	Cope	1

	<ul style="list-style-type: none"> Kabell...dry contact...me konektor RJ45 dhe me gjatesi >=4m...per lidhjen e pajisjeve te paleve te treta (paneleve elektrike) ... 1 cope; 		
--	--	--	--

Infrastruktura aktuale Primary Site është e përbërë nga hardware dhe software sipas të dhënave të mëposhtme

Nr.	Produktet/Mirembajtje dhe shërbimet	Produkti	PN
1	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet Fujitsu Server - dhe specifiku 8 x RX2530M6, 2 x Intel Xeon Gold 6330 28C, 12 x 32GB 2Rx4 DDR4-3200 R ECC. (shiko listen e detajuar tek tabela përkatëse)	PRIMERGY RX2530M6	EWAB002029 EWAB002030 EWAB002031 EWAB002032 EWAB002033 EWAB002034 EWAB002035 EWAB002036
2	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktet DELL EMC Storage - dhe specifiku PowerStore 500T. (shiko listen e detajuar tek tabela përkatëse)	PowerStore 500T	F3HX983
3	Mirembajtja 1 vjecare për Fiber Channel Brocade G620 (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	G620-24-32G-R-Z	FPP1940S004 FPP1940S008
4	Mirembajtja 1 vjecare për Switch ToR Cisco Nexus 3500 (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	SWITCH N3K-C3524P-10GX	FOC2534R4PC FOC2547R3G5
5	Mirembajtja 1 vjecare për Juniper Core Switchet - dhe specifiku për Juniper EX 4200 Switches. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	SWITCH ESMODEL EX 4200-48T	750-033063
6	Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 për produktet IBM System Servers dhe komponentet e tjere përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	Server IBM System x3550 M3	7944KAG
7	Mirembajtja 1 vjecare On-Site për produktin IBM Storage - dhe specifiku IBM Storwize V5030 dhe komponentet e tjere përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	IBM Storwize v5030	2078-312

1. Përshkrimi i kërkesave për mirembajtjen e produkteve hardware Fujitsu Server

- Mirembajtja me mbulimin përë përditesimet me versionet e fundit të firmware dhe drivers.
- Përditësimi falas i aplikacioneve ndihmëse (firmware dhe drivers) në rast të shfaqjes së dobësive (bugs) të shfaqura gjatë operimit.
- Mirembajtja për të gjitha paisjet dhe licensat kërkohet të jetë me kohë përgjigje 4 orë gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 për produktet Fujitsu Servers dhe komponentet e tjerë përbërës	
Përshkrimi i Produktit për Mirëmbajtje	Sasia
PY RX2530 M6 8x 2.5'	8
Intel Xeon Gold 6330 28C 2.0 GHz 42 MB	16
Cooler Kit CPU	16
32GB (1x32GB) 2Rx4 DDR4-3200 R ECC	96
M.2 240GB	8
PFC EP LPE35002 2X 32GB LP	8
PLAN EP X710-DA2 2X 10G SFP OCPV3 X710-DA2 Dual Port 10G SFP+	8
SFP+ Module Multi Mode Fiber 10GbE LC	16
iRMC advanced pack activation key for graphical console	8
Modular PSU 900W platinum	16

2. Përshkrimi i kërkesave për mirembajtjen e produkteve hardware DELL EMC Storage

- Mirembajtja me mbulimin përë përditesimet me versionet e fundit të firmware dhe drivers.
- Përditësimi falas i aplikacioneve ndihmëse (firmware dhe drivers) në rast të shfaqjes së dobësive (bugs) të shfaqura gjatë operimit.
- Mirembajtja për të gjitha paisjet dhe licensat kërkohet të jetë me kohë përgjigje 4 orë gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 per produktet DELL EMC Storage dhe komponentet e tyre perberes	
Përshkrimi i Produktit për Mirëmbajtje	Sasia
Chassis assembly 2U	1
Power supply, 1100 Watt, ac	2

Hard disk drive, 3.84TB, NVMe TLC SSD	18
Memory, 16 GB RDIMM	12
System board	2
System Controller Nodes	2
Microprocessor Intel Xeon CPUs, 24 cores, 2.2 GHz	2

3. Përshkrimi i kërkesave për mirembajtjen e produkteve hardware Fiber Channel Brocade G620

- Mirembajtja me mbulimin për përditesimet me versionet e fundit të firmware dhe drivers.
- Përditësimi falas i aplikacioneve ndihmëse (firmware dhe drivers) në rast të shfaqjes së dobësive (bugs) të shfaqura gjatë operimit.
- Mirembajtja për të gjitha paisjet dhe licensat kërkohet të jetë me kohë përgjigje 4 orë gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 për produktet Fiber Channel Brocade G620 dhe komponentet e tyre perberes	
Përshkrimi i Produktit për Mirëmbajtje	Sasia
Chassis assembly 1U	1
Power supplies for 1+1 redundancy (250W)	2
32/16/8 Gbit SFP+ ports	48
32 Gbit short wave SFP+	24

4. Përshkrimi i kërkesave për mirembajtjen e produkteve hardware Cisco Nexus 3500

- Mirembajtja me mbulimin për përditesimet me versionet e fundit të firmware dhe drivers.
- Përditësimi falas i aplikacioneve ndihmëse (firmware dhe drivers) në rast të shfaqjes së dobësive (bugs) të shfaqura gjatë operimit.
- Mirembajtja për të gjitha paisjet dhe licensat kërkohet të jetë me kohë përgjigje 4 orë gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 per produktet Cisco Nexus 3500 dhe komponentet e tyre perberes	
Pershkrimi i Produktit per Mirembajtje	Sasia
Chassis assembly 1U	1
Power supplies for 1+1 redundancy (400W)	2
1 - 10 Gbps SFP+ ports	48
10 Gbps SFP+ (SFP-10G-SR)	24

5. Pershkrimi i kerkesave per mirembajtjen per produktet Juniper si dhe sherbimet ne site (On-Site)

- Mirembajtja me mbulimin dhe zevendesimin te hardware te difektuar (kosto e perfshire) si dhe perditësimet me versionet e fundit software (kosto e perfshire).
- Perditësimi falas i sistemeve te operimit te paisjeve networking ne rast te shfaqjes se dobësive (bugs) te shfaqura gjate operimit.
- Mirembajtje per te gjitha paisjet dhe licensat kerkohe te jete per 1 vit 12x5 me paraqitje on-site te nesermen e ditës se punës pas raportimit te problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 12x5 next-business-day per produktet EX 4200 dhe komponentët e tjerë përbërës	
Pershkrimi i Produktit per Mirembajtje	Sasia
CORESWITCHESMODEL EX 4200-48T	2

6. Pershkrimi i kerkesave per mirembajtjen e produkteve hardware IBM System Servers si dhe sherbimet ne site (On-Site)

- Mirembajtja me mbulimin dhe zevendesimin te hardware te difektuar (kosto e perfshire) si dhe perditësimet me versionet e fundit te firmware dhe drivers (kosto e perfshire)
- Perditësimi falas i aplikacioneve ndihmese (firmware dhe drivers) ne rast te shfaqjes se dobësive (bugs) te shfaqura gjate operimit.
- Mirembajtja per te gjitha paisjet dhe licensat kerkohe te jete me kohë pergjigje 4 ore gjate periudhës 24x7

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 per produktet IBM System Servers dhe komponentet e tyre perberes	
Përshkrimi i Produktit për Mirëmbajtje	Sasia
Chassis assembly (without front bezel)	2
Power supply, 460 Watt, ac	4
Hard disk drive, 2.5-inch hot-swap, 146 GB, 15K	4
Memory, 8 GB dual-rank DDR3-1333 RDIMM	4
System board	2
Microprocessor, Intel Xeon E5645 2.40 GHz, 12 MB, 80W (six core)	2
SAS/SATA riser card	2

7. Përshkrimi i kërkesave për mirembajtjen për produktin IBM Storwize V5030 si dhe shërbimet në site (On-Site)

- Mirembajtja me mbulimin dhe zëvendësimin të hardware të difektuar (kosto e përfshirë) si dhe përditësimet me versionet e fundit të firmware dhe drivers (kosto e përfshirë).
- Mirembajtja për të gjitha paisjet dhe licensat kërkohet të jetë me kohe përgjigje 4 ore gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Mirembajtja 1 vjecare onsite 24x7x4 për produktin IBM Storwize v5030 Storage dhe komponentët e tjerë përbërës	
Përshkrimi i Produktit për Mirëmbajtje	Sasia
10 Gb iSCSI HOST PORT	4
4TB 7200RPM SAS DISK DRIVE	4
600GB 15K 4GB SAS DISK DRIVE	4
REDUNDANT POWER SUPPLY 800W	2
10 GbE PORT DATA MANAGEMENT	2

Lista e blerjeve/shërbimeve si me poshte:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi
----	------------	--------	-------	-------

1	Mirembajtje e Infrastruktues Existuese Disaster Recovery Site(Listuar Paisjet tek Specifikimet Teknike)	vite	1	
2	Mirembajtje e Infrastruktues Existuese Primary Site (Listuar Paisjet tek Specifikimet Teknike)	vite	1	

Shënim: Për të gjithë artikujt objekt prokurimi, në specifikimet teknike të të cilave është përmendur markë, origjinë specifike, kod apo referencë prodhuesi, autoriteti kontraktor sqaron se këto përcaktime janë bërë me qëllim përshkrimin sa më të saktë të artikujve.

Për këta artikuj në e specifikimeve teknike shtohen fjalët “ose ekuivalent të tij/saj”.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

- Mirembajtje e shërbimeve IT, sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve ne 24/7 ne Site Primar.
- Mirembajtje e infrastruktures Dell në Disaster Recovery ekzistues në mënyrë që të jepet mundësia të mbajnë një kopje të shërbimeve kritike në rast të ndonjë problemi madhor ne Primary Site.
- Krijimi dhe konfigurimi për replikimin e të gjitha makinave virtuale nga site primar në site backup.

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është përmirësimi i infrastrukturës hardware, software si dhe i optimizimit të infrastrukturës me disponueshmeri të lartë për të gjithë shërbimet, duke realizuar shërbimet si më poshtë:

- Mirembajtja dhe konfigurimi e infrastrukturës hardware aktuale bazuar saktësisht në kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike;
- Respektimi i parimit të konfidencialitetit të të dhënave;
- Testimi i përgjithshëm i sistemeve;

Qëllimi i këtij projekti është mirembajtja e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbime ndaj përdoruesve. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Mirembajtja e paisjeve ne Primary Site per performace maksimale.
- Mirembajtja e paisjeve ne Disaster Recovery Site per performace maksimale.

Shpërndarja:

- Në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të “Posta Shqiptare” sh.a.
- Në ambjentet e Drejtorisë së Shpërndarësisë të Filialit Postar Tiranë, pranë “Ish Kinostudios”, Tiranë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

- Shërbimet e mirëmbajtjes së Data Center Primar do të realizohen në Drejtorinë e Përgjithshme të “Posta Shqiptare” sh.a. në adresën Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë.
- Shërbimet e mirëmbajtjes së Data Center Primar do të realizohen në Data Center sekondar do të realizohen në ambjentet e Drejtorisë së Shpërndarësisë të Filialit Postar Tiranë, pranë “Ish Kinostudios”, Tiranë.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2021, 2022 dhe 2023, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 95% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, , dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik konkurues duhet të jete i certifikuar me :

- ISO 9001 ose ekuivalente, (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)
- ISO/IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente, (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit).
- ISO 27001 ose ekuivalente, (për Sigurinë e Informacionit)

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të pakten në datën e hapjes së ofertave.

Ne rast se OE janë pjesëmarrës në tendër si bashkim operatorësh, secili anetar duhet të paraqesë ISO në përputhje me zërat që do të marrë përsipër të furnizoje.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për instalimin, implementimin, dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve ekzistuese.

Në përbërje të stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë:

- a) Të pakten 1 (një) inxhinier elektrik për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike pjesë e kesaj procedure.
- b) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi FUJITSU për Server-at për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
- c) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional” ose ekuivalente nga prodhuesi FUJITSU për Virtualizimin e Serverave për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.

-
- d) Të paktën 2 (dy) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi DELL për Server-at për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
 - e) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi DELL për Storage për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
 - f) Të paktën 2 (dy) specialist të certifikuar në nivel profesional” ose ekuivalente nga prodhuesi VMWARE për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
 - g) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi Juniper për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese për pajisjet e rrjetit.
 - h) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në Network në nivel Profesional për sigurinë.
 - i) Të paktën 2 (dy) specialist të certifikuar ITIL për menaxhimin e proceseve të punës.

Për të gjithë punonjësit e mesipërm, duhet të paraqiten certifikatat përkatëse si dhe operatori ekonomik duhet të vërtetojë se i ka të punësuar për një periudhë jo më pak se 2-muaj nga data e hapjes së tenderit. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime, për të përmbushur kriteret e mesipërme për certifikimet. Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesi:

- Certifikatat përkatëse për secilin nga specialistët e mesipërm;
- Listëpagesat e dorëzuara nepërmjet formës elektronike në organet kompetente, për 2 muajt e fundit;
- Vërtetim nga organet tatimore përkatëse për numrin total mujor të punonjësve të siguruar të paktën për 2 muajt e fundit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
